

Vjersha

ANASTAS DHROSO'

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
8486

Djemtë,
e hekurt

8DH-1
8486

ANASTAS DHROSO

DJEMTË E HEKURT

vjersha



12146

SHTËPIA BOTUESE «NALM FRASHËR»

DJEMTË E HEKURT

Mëhallë i kishte avllitë të shtrembëra,
portat e drunjta sa dy sofate roje,
kalldrëmet me gurë lumi të fshirë çdo mëngjes;
n'oborr, midis dy kumbullave
vareshin çarçafët.

Komshijet e plakura
hutoheshin pas harxheve të ditës;
me shallin supeve të rënë,
mezi blinin barishte për një gjellë.
Vetëm, midis konizmave, magjive,

të heshtura si pjatat edhe lugët,
prisin burrat e tyre të lodhur
të sillnin diçka nga dita
në gishtat e tyre të thatë.

Kishte aq' derte mëhallë jonë,
sa ç'kishte gurë në kalldrëme.
Djemt' i kishte të hekurt,
me këmishat prej basme,

kasketën mbi sy
dhe grushtet në xhepet e fuskeve.
Në xhepet e fuskeve
edhe një grusht hekuri.
U binin kryq rrugëve,
u vërsħellénin xhandarëve,
po s'thyheshin brinjët e mbretërisë
me një grusht hekuri.
Në kopshtin e èndrrave të tyre
rrézohej «Jul Qezari»,
«Nëna» ngrinte si flamur traktet komuniste,
«Armiku i popullit» fshinte syzet i mundur,
Krishti, me sandalet me rripa,
ikte nga rrugët e fshihej në konizma,
kaubojtë suleshin mbi kuajtë e bardhë
të trembur nga të qeshurat e tyre.
Natën vonë, aty midis fletëve
ndizte i menduar llullën Stalini.
Ishin të hekurt
e çuditërisht të ndryshëm
djemtë e mëhallës simë,
e deshën botën e madhe,
ngjyrat e saj dhe popujt;
grushtet që çoheshin për luftë.
Në Totor
ngrinin për Leninin
një aerostat të kuq.
Po ja, një ditë papritur

u dukën në mëhallën time
helmeta me pendë të zeza,
si lule demonësh skëterre.
Ra hija e tyre në oda,
në kumbullat dhe në zemrat tonë.
Në sytë e djemve shkrepëtiu
diçka që u ngjante rrufeve.
E u bënë të gjithë të kuq,
me flamurka të kuq nën këmishë,
me bomba e kobure në xhepa
e tundnin të zjarrtë lart grushtet
e s'trembeshin nga prangat e burgjet
e nxirrin nagantin mesditës,
si të bënин fare thjeshtë ndonjë punë,
rrëzonin bulevardeve spiunët.
Djemtë e mëhallës sime
mëhallën e ngrinin transhe
për yjet që mbanin në zemër.
E tok me ta, për çudi,
u hodhën komshijet e plakura
dhe burrat e tyre të lodhur
e feksi në sytë e të gjithëve,
diçka që përngjante me diellin,
e u jepte ngjyrë tjetër ditëve.

VJERSHA TË HUMBURA

Duke shfletuar një ditar

Vjersha të humbura,
të lëna në sirtarin e një tavoline
si ditë të harruara
nëpër tymin e një aksioni.

Vjersha të humbura,
çelët në rininë time,
kur hidheshin traktet portave,
kur delnin partizanë maleve
dhe u prinin përpara kohërave.

Vjersha të humbura,
si lulet e vonuara,
që mbushin me ngjyra parqet
e nuk i qortojmë për vonesën.

J A R G A V A N I

Si një re në ngjyrë gurkali
një jargavan në kopshtin e shtëpisë.
Në bisqet e hollë i futej trishtimi
nga erërat që frynin
gërmadhave të mbretërisë.

U thyeja degë të gjithëve,
por më të bukurat
i ruaja për Krisën.

Çdo pranverë thyeja degë
për ëndrrat pa krahë të Krisës,
për ëndrrat që mbeten si arna
nëpër fustanet e saj të vjetra.

TË DIELAVE NË MËNGJES

Të dielave në mëngjes
fqinjët e mi
uleshin në sofatet e portave,
preheshin në diell edhe dëgjonin
një gramafon «të çuditshëm»,
që buçiste nga çardhaku i një kurbetlli.
Ishin më të heshtur se sofatet,
më të fortë se sofatet;
mbanin mbi këmishën e arnuar në jakë
gurët e rëndë të mbretërisë.

G J I M N A Z I S T I

Isha edhe unë njëherë gjimnazist
me kasketën çapkënçe mënjanë,
me disa fletore të palosura në xhep
dhe një roman klasik nën sqetull
Në syt' e mi do të shikonit
gjyshërit me jataganë,
këmbëkryq nën hijet e borigave,
me takijet e djersitura mbi gju,
gjithë dimërin e Korçës
futur në shaminë e bukës t'argatëve
dhe mjerimin e rinisë
në fustanet e vjetra të çupave.
Isha edhe unë njëherë gjimnazist
me merakun e këpucëve të prishura,
me një kopje të fshehur në xhaketë
dhe një komunikatë n'astarin e kasketës.
Në syt'e mi do të shihnit
millefin e urejtjen
për ushtarët me pendë të zeza,
që na vunë pushkët mbi fletoret e algjebërës,
mbi shaminë e bukës t'argatëve,

mbi takijet e djersitura të gjyshërve,
mbi fustanet e vjetra të çupave.
Isha edhe unë njëherë gjimnazist
me një broshurë të ndaluar nën' këmishë,
me mendimin në mbledhjen e fshehtë të
rinisë.

Në syt' e mi do të shihnit
një ilegal që bën atentat në rrugë,
partizanë me shami të kuqe ballit,
që mbyllin në zemër shulin e hakmarrjes,
që hedhin dushqeve në baltë
armët dhe lavdinë e armikut,
që mbushin me shpresë hambarët e drithit
dhe na e sjellin Partinë në sofër
të thjeshtë si buka.

Isha edhe unë njëherë gjimnazist
me pranverën supeve si këmishë basme,
me rendin e ditës së mbledhjes të rinisë.
Në syt' e mi do të shihnit
kostumin punëtor të Republikës,
lidhur shaminë e aksioneve të para
përkulur mbi urat e rrëzuara,
që s'mbaheshin vetëm në krahë dhe me
shpâtulla,

po lipsej kënga edhe gjaku
që të mpikseshin
si në luftë.

Isha edhe unë njëherë gjimnazist...

K Y P L A K

Ky plak mban në rrudhat e ballit
të gjitha stuhit' e shekullit.

Ato që tregon, duken legjenda,
veç kur i sheh plasat e duarve
beson se ka pritur si shkëmbi
të gjitha rrebeshet e kohës!

Ky plak ka mustaqe të verdha
nga duhani kaçak që ka pirë,
të fashitëte kushedi se sa brengë
e varre në mote të vështirë.

Ky plak mban në sytë e thellë
erërat e luftës partizane,
cerkat e sa e sa tufaneve
rrugëve të gjata të fitores.

Ky plak mban në zemër të mbjellat,
erën e naftës pas brazdave,
enigmat në fletoret e nipërve,
shkumët e bardha të kaskadave.

Ky plak mban në çapin e rëndë
frymëmarrjen e nxituar në beteja,
frymëmarrjen e ugareve të reja
gjithë ditën e mbushur me kujdesje,
gjithë natën e mbushur me ëndrra.

KËMISHA JESHILE

Tek një fytyrë shpesh qëndron mendimi,
tek një vërsnik i vogël dhjetë vjeç,
që s'kish fuqi të loste tok me ne,
veç tok me ne u rrit duke vështruar
ulur nëpër sofatet e rrugicës.
Priste gjithnjë i varféri të shërohej,
priste babanë e humbur n'Argjentinë.
Dhe babai erdhi
i plakur, i dërrmuar...
i solli vetëm një këmishë jeshile
me kopse prej sedefi.
Por vdiq voglushi, ndoshta nga gëzimi,
se tashti kishte dhe ai baba
e mbi këmishën jeshile ne i vumë
lulet e oborreve tanë
dhe lotët më të dhembshur.
Oh, lotë ne fëmijët kishim shumë!

K E N G A

Në muzgun e një vjeshte,
në ca rrugica me kalldrëm
një shok na shoqëronte me kitarë:
këngët e luftës.
Në atë muzg vjeshte
çdo gjë kish marrë diçka nga kënga jonë,
udhët edhe qyteti,
bari i shkurtër mes gurëve
njerëzit poshtë palltove të trasha
malet dhe horizontet.

NË RRUGËT E QYTETIT

Në rrugët e qytetit tonë
ngricat vinin me strehët prej akulli,
portat prisnin të kaloje ti,
që të besonin se dimri është i bukur.
Mbi buzëqeshje dhe mbi flokë
si quell i kaltër një beretë...
Një ditë një konflikt xhelozije
ma largoi atë quell aqë larg
sa nuk e preknin dot as retë.
Pas xhamave të klasës i tulatur
s'kuptoja dot asnje formulë,
shihja një peizazh të qetë dimri,
që shkundte akullin e degëve të bardha
në zemrën time;
po s'kishte aq akull
sa të më ftohte pakëz zemrën
që çuditërisht besonte
se do të zbrisnin ujërat dhe rrëketë,
se do të zgjohet bari në lëndina,
dhe do të hapej buzëqeshja jote përsëri
duke ma mbushur zemrën.

MARGARITA TUTULANI

Lulet hapën sytë näpër degë,
dielli zu të zgjohet në oborre,
zemrës po na ndizen lule shegë,
plagët u shëruan, zunë kore.

Dielli hapet dhe mbi Margaritën,
buzëqeshj' e saj çeli mbi ne,
mbush me këngë pune gjithë ditën,
mbush me ideale këtë dhe.

I ka shokë gurët në kalldrëme,
i ka motra pemët në rrugica,
mban në sy një diçka të pa thënë
fjongua i bie nga karfica.

Ishte dita me komunikata,
ishte dega e njomë me burbuqe,
ajo ishte yll kur vinte nata,
ajo ishte dita jonë e kuqe.

LENINI

Udhëvet të botës shkon Lenini
me kasketën shuk në grusht të dorës.
Çap' i shpejt' i tij godet asfaltet
dhe i mbush me armë barrikadat,
dhe i mbush me shpresa proletarët.
Udhëve të botës shkon Lenini
me kokën përkulur pak mënjanë.
Nga bardhaku i shokëve pi ujë,
në shtëpit' e tyre shkon të prehet.
Çap' i shpejt' i tij troket në xhungël
si tam-tam alarmi për Afrikën,
bie përmbi telat e kitarës
edhe ngre një marsh për partizanët,
që nga Guatemala n'Argjentinë.
Udhëve të botës shkon Lenini
gurëve të Kilit të gjakosur,
pallton e zbërthyer ia merr era
çap' i shpejt' i tij buçet mbi tokë,

12146



Çap' i shpejt' i tij përshkon planetin,
derdhet në të gjitha kontinentet.

C'është ky triumf në sytë e njerëzve
apo ndjejnë vallë vetëtimën
e agimeve të kuqe që po vinë?
Udhëve të botës prin Lenini...

DO TË VDESIM NJËHERË

Do të vdesim njëherë,
Këmisha e varur pas dere
nuk e dimë se do të mbetet
dhe njëherë do të harrohem.
Por ëndrrat
do të fryjnë pa mbarim
në rrugët e qyteteve tonë,
në sheshet e qyteteve të botës
do të gdihen barrikadave,
do të sulen bulevardeve
në mes të këngëve e ngjyrave
duke valvitur supeve
mantelin e kuq të
komunizmit.

Shpërthyen dasmat këtë gusht
në klubet dhe oborret e qytetit.
Tridhjetë orkestra në një natë
s'u lodhën deri në mëngjes.
Buçiti këng' e «Drenovares» në bregdet
si një urim i largët nga Morava
e mbeti varur si shami e valles
në krahë t'elektrovinçave.

SULEM RRUGËVE TË BARDHA

Unë s'vij te ti, qytet i lindjes,
nga xhadeja
në sedilen e makinës
përgjumur.

Unë zgres te ti nga Mal' i Thatë
në një mëngjes pranvere,
një degë thane mbaj në dorë,
Dhe etja po t'më ketë marrë
shkoj gjej burimet nëpër shtigje,
shkoj gjej në vragat e korijes
ca manushaqe dhe agulice
t'ua hedh kujtimeve nëpër flakë.
E zgres pastaj nëpër kalldrëme,
ku shkoi dikur rinia ime,
me një xhep kumbulle aguridhe
e gati nuk e njoh vendlindjen
kur ngjitem shkallëve të pallateve,
kur vërvshëllimave tona çapkene
sot iu përgjigjet kori i sirenave
të uzinave e fabrikave.

ERËRAT E KUJTIMEVE

Erërat e kujtimeve gjithnjë fryjnë,
erërat e luftës ngrihen në zemër,
erërat e këngëve,
erërat e trimave:
partizanë të bukur,
partizanë të rinj,
partizanë që flenë korijeve
me jakën e këmishës zbërthyher,
partizanë që digjen nga hakmarrja,
që mbajnë pushkët në dorë
e zbresin monopateve
kur yjtë janë të ftohtë.
Partizanë që gjumi natën nuk i merr
se ëndrrat iu rendin larg
në barrikada dhe revolucionë.
Partizanë që zbritën poshtë në qytete,
që mbetën lart në male,
e ndjejnë akoma përmbi ballë
dorën e një shoku të vrarë.

S T E N L I V I L

Mbi Stenlivil
yjet do tē shuhen sonte,
plumba tē tjerë do tē bien
mbi trupin e Lumumbës.
Me kétë gjëmë sonte flenë
xhadetë, xhunglat urat
dhe Stenlivili.

Nuk qan revolucioni,
mbyll syt' e shokëve që mbetën hapur
si copëza akulli nëpër rrugë,
si copëza akulli
në duart dhe në zemrën e Afrikës.
Godet revolucioni,
ngrihet që nga transhet' e dhembjes
dhe tē gjakut
si një pranverë plot burime
për buzët e zhuritura t'Afrikës.

Q Y M Y R X H I N J T E

Shumë larg shtëpisë, tutje nëpër pyje,
iknin qymyrxhijntë me zemër të tħyer,
pas i ndiqnin mushkat edhe një grusht **yje**,
zilet tringellonin diċka mallēngjyer.

Nxinte një kalibe e vogël si zgħua,
prisnin me sépaté sa u mpihej sħtati;
pērkēdħelniñ mushkat mbrémjes nē **perrua**
nga jelet e tyre u kujtohej fshati.

Udh' e qymyrxhijnjet e ngushtë, e **mjerē**
shtrihej nëpér shekuj, zgħatej pa pushuar
għersa nëpér male fryu një tjetṛer erë,
dhe u ngħitien mushkat me dyfeke **ngarkuar**.

S H T E P I A

Shkova një mëngjes nga ajo rrugë
që shtrihet tejpërtej rinisë sime.
Shtëpia ku u linda dhe u rrita
m'u duk si e rinuar nga pranvera,
që gjelbëronte luleve e pjergullave
tek mbushnin plot oborrë e ballkonë
sikur të prisnin diçka të gëzuar.
Dhe ja papritur, sapo vura këmbën,
më frynë si veri kujtimet
dhe e ndjeva veten prap' në atë shtëpi
me hark prej thupre e shigjetë
dhe me një shkremtimë nëpër sy
gati për aventurë...
E ja tek ndodhem prap' në atë odë
me nënën time të thatë e të pakët
duke vështruar nga penxheret
tek hynë stinët në oborrin tonë
si miq të largët e të afërt.
Ka mbi oxhak stoli prej tunxhi

dhe «Gjenevefa» nëpër mure,
në qoshen përmbi derë regëtin
një flakëz rrotull syve të shën-Kollit;
deg' e bajames bie përmbi xham
nazike,
lidh tantellat e pranverës
si krahë fluturash transparente.
Goren' i maleve plot barut
frym e gjëmon gjër në musandra,
ditën e mbush' me këngë lufte.
Nëna,
plot drojtje e besim të thellë,
fsheh pas aureolës të shën-Kollit
traktet e luftës,
që do t'shpérndajmë sonte bashkë **rrugëve**.

N A T È

Natë,
tani bie dëborë në qytetin e lindjes.
Fëmijët flenë dhe nuk e dëgjojnë
përrallën e bardhë t'oborreve.
Në rrugët e heshtura,
hipur në slita t'argjënda
rrëshqasinëndrrat e tyre.
Ndonjë bie
dhe u fryn gishtave të ngrirë.
Të tjerët rendin
gjer jashtë nëpër kodrat,
ku dremisin borigat,
me një shark të bardhë supeve.

M I Q T E

Nganjéherë miqtë janë si stinët,
të ngrohtë,
të freskët,
të ftohtë.

Po gjejmë shpesh edhe miq të mirë,
miqësi me rrënje të thella,
me degë të gjelbëra.

Në hijet e këtyre miqësive
prehemi,

zemrës i hapen mijëra lule.

Flasim me këta miq për botën,
për njerëzit e mirë,

për ata që i gjen dielli majë skelës,

për ata që i le dielli galerive,

për ata që bëjnë bustin e Leninit,

për ata që flenë xhunglave me armë,

për atë që mban në zemër hallet tona,

diellin tonë.

K A J U A

Bujta një natë te ca miq të mirë
që më shtruani gjithë ç'patën
tok me bukuritë e zemrës.

Folëm për të mbjellat e për vreshtat,
folëm si pihet rakia e fortë
që nxjerr flakë jeshile.

Pastaj në odë hynë erërat e luftës
dhe flakëroi balli i miqve të mirë
nga afshi për marshimet partizane,
për sulmet tek ndizeshin yjtë,
për gjakun që iu ngrohu diku shpatullën.

Por në të gjitha kujtimet e tyre,
si yll i afërt, mes yjeve të largët
ishte fjala dhe zemra e Kajos,
ishte Kajua në mes të plumbave,
afër lodhjes dhe plagëve të shokëve,
ishte Kajo Karafili
atje ku duhej zemra më shumë se arma.

NË FSHAT

I gjeta midis fletëve burimet,
po nuk më ndjek njeri në këto shtigje,
se shpejt burimet do shpërthejnë
në odat ku harruar fle bucela,
ndaj miqt' e mi në mbrëmje bisedojnë
për rubineta e tuba të xinguar.

NË KËTO DHERA RRËZË GRAMOZIT

Erdhi plehu kimik
në këto dhera rrëzë Gramozit,
kur meraku për drithin
i nxirrte mendimet dhe diellin,
ku çdo rrënje lagej me gjak,
ku hidhnin e mbillnin një killë
dhe korrnin një killë,
ku s'kish bukë dhe kripë,
ku rropateshin burrat
me poture e këmishë të grira.
Erdhi plehu kimik
në këto dhera rrëzë Gramozit
rrëmbeu vlagën e plisave
dhe e mblodhi në çdo rrënje;
mbushi arat me drith' e me këngë
mbushi zemrat me ëndrra,
erdhi brënda në oda
ku të deh er' e bukës së ngrohtë
e gatuar nga llëra e zhveshur
ë makinës së brumit.

K A M M A L L

Kam mall të mblidhem tok me shokët,
me shokët, që dikur u zumë për një cingël,
me shokët, që ndamë bashkë gështenjat

edhe lotët.

Dikur me dy-tri vërvshëllima
i mblidhja në minutë,
po ku t'i gjej sot vallë shokët e mi
nëpër atdhe shpërndarë?

Më shkruajnë shpesh se më kujtojnë
nga fushat plot me drithë,
nga kombinatet e nga ministritë,
nga poligonet e katedrat.

Për mua prap' i marrka malli
kur kërrusen mbi projekte,
kur heqin dorezat të menduar

në sallën e operacionit,
kur kthehen mbrëmjes në shtëpi

e shlodhen duke thithur një cigare.
Kam mall të mblidhem tok me shokët,
të flasim për flokët e tħinjur,
e të dëgjoj fjalën e mënçur,
për kozmosin, elektronikën,
për genet dhe dialektikën.
Kam mall të mblidhem tok me shokët
në gaz' e tyre të mbush grushtat
e nga triumfi i tyre zemrën.
Pastaj të ngremë gotën bashkë,
të pimë për pranverën nëpër rrugë,
pranverën e ballkoneve toni,
edhe pranverën e zemrave.

NJË SY GJUMË NË XHADE

Kabinet tuaja
që marrin një sy gjumë në xhade
nuk i pranojnë vjershat,
që qajnë në çdo rimë.
Ndaj dua që kjo këngë
çkujdesur të mbështetet në sedile
e thjeshtë dhe e ngrohtë
si xhupet prej meshini,
që ju mbështjellin shpatullat.
Ndaj dua që me ju
cigare të këmbej në netët e beharit
dhe gjumin t'ju largojë.
Ndaj dua që të sulet në udhët e atdheut
me këngën tuaj bashkë
e digave t'ju shpjerë
çimento edhe hekur.

K Y B R O N X

Ky bronx i Shkurtes
mbushur me këngë,
mbushur me èndrra
e mendime!

Ky bronx i Shkurtes
rri natën vetëm,
u thotë njerëzve:
— natën e mirë! —

U thotë trenave:
— udhën e mbarë!

Ky bronx i Shkurtes
s'fle asnjëherë,
niset në turn
bashkë me yjet.

Ky bronx i Shkurtes
nuk e ngre jakën
kur bien shirat.
Flokët e lagur

ia than era,
duart e ngrira
ia ngroh agimi.
Ky bronx i Shkurtes
do kapërcejë
shekujt që vinë
si një flamur
hapur në luftë.
Ky bronx i Shkurtes
në muzeume
nuk do të hyjë,
buzë trasesë
do nisë brezat
drejt horizonteve.

NUSE SHTËPIAKE

Qindismat e shtëpisë
në xham, në mur e në tryezë,
me penjët e mëndafshë,
të lidhënë nderrat dhe rininë,
të qepën këngët.
Ngrehu e sulu nga shoqet,
që kanë diellin në fytyrë,
që ngrenë një baluke nga balli
e ulen mbërthejnë motorrat,
Sulu me 'to në uzinë
e folë si të ishe n'oborin e shtëpisë
pa ndroje e me zë të fortë.
Në duart e nxira nga vajrat
le të rriten këngët dhe fëmijët.

N A S I V O D I C A

O flekëverdhi delikat,
ku e mblodhe gjith' atë dritë
në syt' e tu të kaltërt?
Në hijet e dushqeve,
ku fshihej mendimi i diellit,
shelgjishteve buzë Osumit,
që flinte
mbuluar me atllasin e hënës?
Porta e vjetër, e shtrembër,
të priste me një rënkim rrëqethës.
Lart në odë,
në mure dhe në fytyra
shtrinte gishtat e gjatë mjerimi.
Në përrallat e nënës
frushullonin kuçedrat
nëpër grykat e projëve plot myshqe.
Hambari pa drithë
shtrihej si një sprihë tronditëse
në magjet e në ëndërrat
dhe në lugët e shtëpisë.

* * *

O mustaqeverdhë partizan,
ku e gjete gjith' atë zjarr
në zemrën tënde të mirë?
Në supet e fshatarëve,
që mbanin baltën e arave edhe në
gjumë,
në çehren e myrëtyer të çirakëve,
që s'kishin rini kurrë,
në kupën e drunjtë t'argatëve
hedhur bosh në fund të torbës?
Ndehur në ballë si flamur
shami e kuqe,
derdhur nëpër muskuj stuhi e luftës,
ngritur përmbi zemër dielli i Partisë.
O partizan i bukur i «Hakmarrjes»!
Hyre në èndrrat e fëmijëve,
në shpresat e burrave dhe të grave,
në çdo stromë le erën e malit
dhe të yjeve.

B A B A I

Nëna më tregonte shpesh për babanë,
që ishte burrë i urtë,
që hallet s'e rrëzuan asnjëherë
e pinte tok me shokë.

I desh dhe u besonte miqvet
dhe mbeti në zemrat e tyre
si myshku në gurët e krojeve.
Për Amerikën shpesh i fliste nënës
që ishte shumë e rëndë,
se ngrihej pas mesnate
me llambën e sinjalit
që të përcillte trenat;
priste i vetëm buzë binarëve,
në ato vise të panjohura,
pa asnijë shok, pa asnijë mik,
me peshën e kujtimeve në zemër
dhe vetëm cincëri llafazan
në ngashërimë shpesh e mbyste.

TI NUK U KTHEVE

Ti nuk u ktheve në shtëpi
me ligjet e revolucionit
në vezme ngjeshur
dhe me shaminë e kuqe qafës.
Nuk u ktheve
që në kalldrëmin e vjetër të rrugicës
komshinjve t'u tregoje
diçka ngajeta partizane.
Nuk u ktheve tek ajo port' e vjetër,
ku edhe sot të pret,
e ulur në sofat,
një nënë.
Ti mbete si një këngë maleve,
si kënga e të gjitha ditëve.

NË FUSHAT TONA

Në fushat tona ka diell,
në fushat tona ka drithë,
në fushat tona ka këngë,
ka lule dhe politikë;
në fushat tona
hapet kimia në dço rrënje,
sulet në çdo ugar teknika,
s'ka ethe e mushkonja
shtrin socializmi krahët
në fushat tona.

J A M S O N T E

Jam sonte me ata
që hedhin digave betonin
dhe gdhihen tok me yjet mbi lopatë
me shijen e çimentos nëpër dhëmbë.

Jam me ata
që bëjnë shpatullat e digës
në këto shtigje ku kaluan shekujt
në mes të kryqit e të shpatave
mbushur me dregëza e kuje.

Jam me ata
që mbjellin këngët në beton
në turnet e spërkatura me djersë
e mbushin natën tonë plot me yje.

MARSHIMI HEROIK

Ne, vëllezër, prej hekuri nuk jemi,
thonjtë po na nxihen në dëborë;
uri edhe të ftohtë kemi,
çeliku i pushkës ngjit në dorë.

Gjunjët na u lodhën, na u mpinë,
akull përmbi zverk edhe mbi flokë,
ripi i gjerdanit na djeg shpinën,
mendimet si çekan bien në kokë:

E rëndë bije nata mbi Shqipëri
Me thonjtë e robërisë mu në fyt,
Por ne besojmë fort në drejtësi
dhe s'ka tufan e det që të na mbytë.

Ecim, në këmbë marrim një sy gjumë,
dhe plagët gjith' më këmbë i shërojmë,

agimet majë maleve i zurnë,
mbi supet e Mehmetit i shikojmë.

Stuhi e plumbave ngrihet nga çdo anë,
po na qëllojnë grykat dhe frëngjité,
pushkën dhe Partinë kemi pranë
i vemë zemrat tona mbi çdo pritë.

Po mblidhen batalionet përmbi Skroskë:
hyn fjal' e komandantit në mornicë,
hyn fjala e Partisë gjer në kockë,
më thellë se urija dhe çdo ngricë.

Rrëmben nga dejet tona zemra zjarr,
rrëmben nga sytë dritë e vezullime,
ngrihet si një betim që nga ky «Varr»¹⁾
të mbrojë Enverin dhe Partinë trime.

Vrundulli armik pusitë i përpin,
e fshikull' i cfilities përvëlon,
e «Zeza Çermenikë»²⁾ dot s'e nxin
yllin, që përmbi ballë rrezëllon.

1) Vendi quhej «Varri i Plakës»

2) «Çermenik' e Zezë» quhet krahina.

PASQYRA E LANDËS

Faqe

Djemtë e hekurt	3
Vjersha të humbura	6
Jargavani	7
Të dielave në mëngjes	8
Gjimnazisti	9
Ky plak	11
Këmisha jeshile	13
Kënga	14
Në rrugët e qytetit	15
Margarita Tutulani	16
Lenini	17
Do të vdesim njëherë	19
Gusht 74	20
Sulem rrugëve të bardha	21
Erërat e kujtimeve	22
Stenlivil	23
Qymyrxhinjtë	24
Shtëpia	25
Natë	27
Miqtë	28
Kajua	29
Në fshat	30
Në këto dhera rrëzë Gramozit	31

Faqe

Kam mall	32
Një sy gjumë në xhade	34
Ky bronx	35
Nuse shtëpiake	37
Nasi Vodica	38
Babai	40
Ti nuk u ktheve	41
Në fushat tonë	42
Jam sonte	43
Marshimi heroik	44

Redaktor: Dhimitër Fullani
Piktor: Svetllana Strazimiri

Tirazhi 1.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72
Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1975